

---

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI  
MIDIS**

**DHOMËS KOMBËTARE TË ZEJEVE**

**DHE**

**QENDRËS MULTIFUNKSIONALE “NEW GENERATION”**

---

Tiranë më 13.04.2021

Qëllimi i këtij Memorandumi shpreh gadishmërinë e palëve për një angazhim, bashkëpunim dhe interes të përbashkët në rritje të cilësisë së sektorit të zejeve dhe vecanërisht sektorit të shërbimit të fushën e perkujdesjes dhe artit trupor.

Duke krijuar një kornizë gjithëpërfshirëse për të lehtësuar aktivitetet ekzistuese dhe të reja të dakorduara në mënyrë reciproke përmes shkëmbimit të informacionit që konsiderohet i përshtatshëm për secilën palë.

Përvec kësaj, ekipe të vecanta të Palëve mund të hyjnë në bashkëpunime, ku aktorë të ndryshëm duke përfshirë profesionistë nga fusha e parukerisë, Estetikës, Fizioterapisë estetike, Estetikës masazho kuruese, make-up, etj, mund të bien dakort për të kryer aktivitete të ndryshme promovuese, trajnuese, konkurse etj.

*Marrëveshjet e duhura formale mund të ekzekutohen sic kërkohet në ligj, ose sipas politikave të Palëve, për çdo aktivitet që rezulton nga ky bashkëpunim.*



Mbështetur në Kodin Civil, neni 79 e në vijim, lidhet ky Memorandum bashkëpunimi midis palëve:

Dhoma Kombëtare e Zejtarisë, (më tej DHKZ) e përfaqësuar nga Kryetari. Z. Luan Bregasi

*Dhe*

Qendra Multifunktionale New Generation, (më tej QMNG) përfaqësuar nga Drejtori z. Ilir Tafaj

Bien dakort si më poshtë:



## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1

#### Qëllimi i Memorandumit

- 1) Për të krijuar Kornizën Gjithëpërfshirëse për bashkëpunimin midis Palëve
- 2) Të lehtësojë aktivitetet e dakorduara në mënyrë reciproke, në përputhje me politikat dhe procedurat për decilën palë

### Neni 2

#### Fushat e bashkëpunimit

Palët bien dakort si më poshtë:

- 1) Të mbajnë komunikim efektiv ndërmjet tyre për të realizuar projekte, apo trajnime me interes për të dyja Palët. të zhvillojnë projekte bashkëpunuese në interes për të dyja Palët;
- 2) Në organizimin e provimeve në kuadër të marrjes së titujve profesionalë “Ndihmës Mjeshtër”, “Mjeshtër” dhe “Mjeshtër me Përvojë” për ish studentët dhe kursantët e QMNG, që plotësojnë kushtet e titujve.
- 3) Të ndajnë njohuritë dhe të dhënat që avancojnë interesin reciprok të Palëve në përputhje me procedurat dhe politikat e secilës palë;
- 4) Të publikojnë dhe shpërndajnë rezultatet e bashkëpunimit, në përputhje me politikat e secilës palë;

### Neni 3


#### Të drejtat dhe detyrimet e Palëve

Ky Memorandum bashkëpunimi përshkruan në terma të përgjithshëm bazën mbi të cilën Palët synojnë të bashkëpunojnë. Ai nuk krijon detyrime detyruese dhe të detyrueshme nga asnjë Palë. Të gjitha aktivitetet e ndërmara në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit i nënshtrohen miratimit të vetë Palëve dhe /ose projekteve përkatëse të Komiteteve dhe gjithashtu i nënshtrohen disponueshmërisë së personelit dhe resurseve. Ky Memorandum nuk ndikon në aftësinë e Palëve për të hyrë në marrëveshje të tjera.

### Neni 4

#### Kohëzgjatja e Memorandumit të Bashkëpunimit

- 1) Bashkëpunimi profesional dhe krijës është në një afat të pacaktuar;



- 2) Afati i kohëzgjatjes së Memorandumit të Bashkëpunimit midis dy Palëve mund të ndryshohet dhe në rast nevojë me pëlqimin e të dyja palëve;
- 3) Palët mund të zgjedhin të ndërpresin bashkëpunimin duke njoftuar njëra tjetrën me një shkresë zyrtare 15 ditë përpara largimit. Nëse secila nga palët zgjedh të largohet nga ky Memorandum në përputhje me parashikimet e këtij Neni, është e detyruar për të përfunduar projektet për të cilat palët janë përfshirë basharisht.

#### **Neni 5**

##### **Gjuha e përdorur**

Ky Memorandum bashkëpunimi hartohet në dy kopje, në gjuhën shqipe dhe me vlerë të njejtë, midis DHKZ dhe QMNG.

#### **Neni 6**

##### **Besueshmëria e Palëve**

- 1) Palët duhet të veprojnë në besueshmëri të plotë, për të siguruar aritjen e të gjithë objektivave të marrëveshjes;
- 2) Mospajtimet ose interpretimet eventuale të ndryshme të pikave të kësaj marrëveshjeje do të rregullohen në mënyrë miqësore me marrëveshje konsensuale;
- 3) Për të siguruar një komunikim të vazhdueshëm me qëllim zbatimin e pikave të këtij Memorandumi, palët caktojnë personat dhe pikat e kontaktit midis tyre;

### **ORGANIZIMI I I PËRBASHKËT PROVIMEVE**

#### **PËR MARRJEN E TITUJVE**

#### **Neni 7**

##### **Provimet për marrjen e titujve**

- 1) Në bazë të Rregullores së veprimtarisë së DHKZ, provimet për marrjen e titujve “Mjeshtër me përvojë”, “Mjeshtër” dhe Ndihmësmjeshtër” zhvillohen në ambientet e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë, dhe në ambientet e QMNG.
- 2) Provimi i teorisë është provimi i detyruar që vërteton se individi zotëron njohuri të teoretike profesionale më themelore për marrjen e titullit.
- 3) Provimi i praktikës është provim i detyruar që vërteton se individi ka fituar aftësitë praktike profesionale më themelore për marrjen e titullit.



- 4) Provimi i teorisë profesionale dhe i praktikës mbikqyret nga një përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Zejtarisë dhe një specialist i fushës përkujdesit dhe artit trupor në bazë të rregullores “Për zhvillimin e provimeve, si dhe përbërja e komisioneve për dhënien e titujve ‘Mjeshtër me përvojë’, ‘Mjeshtër’ dhe ‘Ndhmësmjeshtër’ në Dhomën Kombëtare të Zejtarisë”, miratuar nga DHKZ.
- 5) Kalimi me sukses i provimit i jep individit titullin “Mjeshtër me Përvojë”, “Mjeshtër” ose “Ndhmësmjeshtër”

### **Neni 8**

#### **Komisionet e Vlerësimit**

#### **Komisioni i vlerësimit të aftësive të fituara që jep titullin “Mjeshtër me Përvojë”, “Mjeshtër” dhe “Ndhmësmjeshtër”**

Në bazë të Rregullores së veprimtarisë së DHKZ, komisioni përbëhet nga:

- 1) Presidenti / Sekretari i Përgjithshëm ose një titullar i Dhomës Kombëtare të Zejtarisë
- 2) Një anëtar i Kryesisë / Asamblesë ose një specialist në sektorin përkatës
- 3) Specialist i fushës/ përfaqësues i QMNG me të cilin bashëpunon DHKZ, sipas Nenit 3 të kësaj rregullorje

### **Neni 9**

#### **Vlerësimet e provimeve**

- 1) Për provimin e teorisë profesionale të integruar:
  - a. Vlerësimi bëhet në bazë të skemës së vlerësimit të hartuar nga Dhoma Kombëtare e Zejtarisë në bashkëpunim me QMNG
  - b. Secili prej anëtarëve bën vlerësim individual.
  - c. Vendosja e notës përfundimtare bëhet pas diskutimit mes anëtarëve komisionit.
- 2) Për provimin e praktikës profesionale të integruar:
  - a. Vlerësimi bëhet në bazë të skemës së vlerësimit të hartuar nga komisioni.
  - b. Secili prej anëtarëve të komisionit bën vlerësim individual.
  - c. Vendosja e notës përfundimtare bëhet pas diskutimit mes anëtarëve të komisionit.

### **Neni 10**



### Lëshimi i certifikatave të titujve

- 1) Certifikatat përkatëse për titujt e fituar lëshohen nga DHKZ brënda afateve.
- 2) Modeli i Certifikatës përcaktohet nga DHKZ;
- 3) Certifikata i lëshohet vetëm personit, dhe vetëm pasi ai të ketë shlyer detyrimet financiare, të përcaktuar në rregulloren e DHKZ.
- 4) QMNG, në bazë të politikave të saj të lehtësimit dhe të përkrahjes për studentët e saj, mund të bëjë edhe subvencionin e saj të pjesshëm ose të plotë.


### Neni 11

#### Afatet kohore të eksperiencës në profesion që nevojiten për të hyrë në provimet për marrjen e titujve

- 1) QMNG i propozon DHKZ-së periudhat/ afatet kohore të eksperiencës në profesion që duhet të plotësojë çdo profesionist, që synon të marrë titujt “Mjeshtër me përvojë”, “Mjeshtër”, dhe Ndihmësmjeshtër” në fushat e Parukerisë, Estetikës, Masazherisë Estetiko-kuruese, Fizioterapisë Estetike, Manikyr-Pedukyr, Make up, Berber etj.
- 2) Këto afate janë paraqitur në shtojcën 1, të këtij Memorandumi
- 3) Periudhat/ afatet kohore të eksperiencës në profesion që nevojiten për tu plotësuar nga një provim në provimin tjetër të nivelit më të lartë, të miratuara në këtë Memorandum synojnë:
  - a) vendosjen e profesionistëve në kushte të barabarta, pavarësisht në ç’rrugë e kanë filluar profesionin.
  - b) vlefhtësimin e njohjes së të nxëniet të mëparshëm në QMNG, eksperiencia në New Generation Start UP zone, ecurinë e suksesshme në profesion në Sallone, Qendra estetike, etj.
  - c) të sigurojë **përputhshmëri ndërkombëtare** të dokumenteve certifikuese të lëshuara.
  - d) ruajtjen e dhe rritjen e cilësisë së profesionit dhe shërbimeve që i ofrohen klientelës;

### Neni 12

**Kriteret që duhet të plotësojë individi që të fitojë titullin “Mjeshtër me Përvojë”, “Mjeshtër” dhe “Ndihmës mjeshtër” nga Dhoma Kombëtare e Zejtarisë**



- A) Për të fituar titullin “Mjeshtër me Përvojë” aplikanti i duhet të plotësojë disa kritere që janë:

**Kritere të detyrueshme**


- a. Të jetë anëtar i Dhomës Kombëtare të Zejtarisë
- b. Të paraqesë Mjetin e identifikimit
- c. Të ketë Diplomë të shkollës së mesme përgjithshme / profesionale/
- d. Të ketë Diplomë Profesionale 1 ose 2 vjecare, (mbi të mesmen), në fushën përkatëse /ose Certifikatë që ka mbaruar Kurs 3, 6, 9 Mujor në një fushë të artit dhe kujdesit trupor.
- e. Të ketë mbi 10 vite eksperiencë pune në profesion, në rastin e parë dhe mbi 15 vite eksperiencë në profesion në rastin e dytë (shih shtojcen 1)
- f. Të jetë vlerësuar të paktën një herë për një punë të vecantë të tij ( punë inovative)
- g. Të ketë eksperiencë në trajnimin dhe kualifikimin e ndihmësve, ose ndihmës mjeshtërve
- h. Të ketë promovuar aktivitetin e tij dhe aftësinë krijuese
- i. Të paraqesë raportin mjeko –ligjor që dëshmon se është i aftë për punë

**Kritere të tjera plotësuese**

- a. Të paraqesë Letër referencë nga punëdhënësi të mëparshëm
- b. Të ketë kualifikime të tjera të certifikuara në profesionin e caktuar
- c. Të ketë njohuri në implementimin e mekanizmave të reja në fushën e tij
- d. Të ketë botuar një libër në profesion
- e. Të ketë mbikqyrur të paktën 5 ndihmës që u ka mësuar zejen
- f. Të ketë pasur angazhime dhe të ketë shkëmbyer përvoja kombëtare dhe ndërkombëtare
- g. *Gjate provimit të praktikës aplikanti për titull duhet të demonstrojë një punë inovative të tij e cila e identifikon dhe për të cilën është vlerësuar.*

- B) Për të fituar titullin “Mjeshtër” aplikanti i duhet të plotësojë disa kritere që janë:

**Kritere të detyrueshme**





- a. Të jetë anëtar i Dhomës Kombëtare të Zejtarisë
- b. Të paraqesë Mjetin e identifikimit
- c. Të ketë Diplomë të shkollës së mesme përgjithshme / profesionale/
- d. Të ketë Diplomë Profesionale 1 ose 2 vjecare, (mbi të mesmen), në fushën përkatëse /ose Certifikatë që ka mbaruar Kurs 3, 6, 9 Mujor në një fushë të artit dhe kujdesit trupor.
- e. Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune si “Ndihmësmjeshtër” (shih shtojcen 1)
- f. Të paraqesë raportin mjeko –ligjor që dëshmon se është i aftë për punë
- g. Të përvetësojë informacionin e duhur për provim i dhënë nga Komisioni sipas fushës përkatëse dhe i shpallur në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Zejtarisë.

#### **Kritere të tjera plotësuese**

- a. Të ketë njohuri në implementimin e mekanizmave të reja në fushën e tij
- b. Të ketë të paktën 1 certifikatë kombëtare /ndërkombëtare
- c. *Gjatë provimit të praktikës aplikanti për titull duhet të demonstrojë një punë inovative të tij e cila e identifikon dhe për të cilën është vlerësuar.*

#### **C) Për të fituar titullin “Ndihmës Mjeshtër” aplikanti i duhet të plotësojë disa kritere që janë:**

##### **Kritere të detyrueshme**

- a. Të jetë anëtar i Dhomës Kombëtare të Zejtarisë
- b. Të paraqesë Mjetin e identifikimit
- c. Të ketë Diplomë të shkollës së mesme përgjithshme / profesionale/
- d. Të ketë Diplomë Profesionale 1 ose 2 vjecare, (mbi të mesmen), në fushën përkatëse /ose Certifikatë që ka mbaruar Kurs 3, 6, 9 Mujor në një fushë të artit dhe kujdesit trupor.
- e. Të ketë përfunduar kohën e përcaktuar sipas kontratës për kualifikimin profesional ndërmjet ndihmësit dhe subjektit zejtar të regjistruar në regjistrin e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë<sup>1</sup> (shih shtojcen 1)

<sup>1</sup> Sipas pikës B të Kontratës për kualifikimin profesional ndërmjet ndihmësit dhe subjektit zejtar, kontrata është e publikuar në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Zejtarisë [www.dhkz.org.al](http://www.dhkz.org.al) dhe në fletoren zyrtare

- f. Të paraqesë raportin mjeko –ligjor që dëshmon se është i aftë për punë
- g. Të përvetësojë informacionin e duhur për provim i dhënë nga Komisioni sipas fushës përkatëse dhe i shpallur në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Zejtarisë.

#### **Kritere të tjera plotësuese**

- a. Të zotërojë njohuri teorike dhe praktike të nevojshme në ushtrimin jo të pavarur në profesionin përkatës
- b. Të ketë të paktën 1 certifikatë kombëtare /ndërkombëtare
- c. *Gjatë provimit të praktikës aplikanti për titull duhet të demonstrojë se zotëron njohuritë e nevojshme në ushtrimin jo të pavarur të profesionit përkatës*

### **Neni 13**

#### **Ankimimi**


Sipas nenit 21 pika 1 të ligjit nr 70/2016” Për Zejtarinë në Republikën e Shqipërisë”:

- 1) Personi mund të ankimojë rezultatin e provimit.
- 2) Vendimet e komisioneve të vlerësimit mund të ankimohen në komisionin e apelit, i cili ngrihet nga Dhoma Kombëtare e Zejtarisë në bashkëpunim me Ministrinë Përgjegjëse për Kualifikimet / institucionet përkatëse të përmendura në Nenin 3 të kësaj rregullorje.
- 3) Nëse aplikanti për titull nuk e kalon provimin atëherë ai ka të drejtë të aplikojë përsëri dhe pagesa e provimit të parë nuk është e vlefshme për provimet e tjera.

### **Neni 14**

#### **Dispozita përfundimtare**

- 1) Këtij Memorandumi nuk t’i bëhet asnjë ndryshim në mënyrë të njëanshme, përveç se me shkrim dhe pasi palët të kenë rënë dakort midis tyre dhe të kenë autorizuar ndryshimin;
- 2) Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Dhoma Kombëtare e Zejeve dhe Qendrës Multifunkionale “New Generation”, dhe është i vlefshëm pa kufizim kohe, derisa palët të mos kenë kërkuar me shkrim shfuqizimin ose shuarjen e tij;
- 3) Prishja në mënyrë të njëanëshme e këtij memorandum mund të bëhet në cdo kohë nga njëra prej palëve, por duke lajmëruar me shkrim 15 ditë më parë Palën tjetër;





- 4) Gjatë zbatimit të memorandumit, mund të ndryshohen apo shtohen dispozita të tjera në Memorandum, por duke rënë më parë dakort midis Palëve.

#### Neni 15

Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në dy (dy) kopje origjinale, njëra prej të cilave arkivohet në Dhomën Kombëtare të Zejeve” dhe njëra për Qendrën Multifunktionale “New Generation”.

#### Neni 16

Data e nënshkrimit është edhe data e hyrjes në fuqi të këtij Memorandumi.

Për:

**DHOMËN KOMBËTARE TË ZEJEVE**

**Z. Luan Bregasi**



Për:

**QENDRËN MULTIFUNKSIONALE  
“NEW GENERATION”**

**Z. Ilir Tafaj**

